



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.100

28 korrik

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.491, datë 6.7.2011

Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të pasurisë me sipërfaqe 16 ha, në zonën kadastrale nr.2488, fshati Lohe e Sipërme në komunën Shkrel të qarkut të Shkodrës, si dhe për një ndryshim në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.406, datë 8.4.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Shkrel e qarkut të Shkodrës”, dhe nr.1524, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme në komunën Shkrel të qarkut të Shkodrës” 4023

Urdhër i METE
nr.477, datë 27.6.2011

Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurës së hartimit të aktit të miratimit dhe aktit të refuzimit për aplikimet e lejeve minerare..... 4026

VENDIM
Nr.491, datë 6.7.2011

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË, TË PASURISË ME SIPËRFAQE 16 HA, NË ZONËN KADASTRALE NR. 2488, FSHATI LOHE E SIPËRME NË KOMUNËN SHKREL TË QARKUT TË SHKODRËS, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.406, DATË 8.4.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA SHKREL E QARKUT TË SHKODRËS”, DHE NR.1524, DATË 19.11.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME NË KOMUNËN SHKREL TË QARKUT TË SHKODRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të pronës së paluajtshme me sipërfaqe të përgjithshme 16 (gjashtëmbëdhjetë) ha, në zonën kadastrale nr.2488, e ndodhur në fshatin Lohe e Sipërme në komunën Shkrel të qarkut të Shkodrës, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e Qendrës së Paraburgimit dhe të Burgut, Shkodër.

2. Sipërfaqja prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) ha, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, përmendet në faqen 21, në zërin kadastral tokë – arë, të listës së inventarit, bashkëlidhur vendimit nr.1524, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme në komunën Shkrel të qarkut të Shkodrës”.

3. Sipërfaqja prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) ha, e cila ndodhet e përfshirë edhe në pasurinë e listuar me nr.121, me përshkrimin “Ekonomi pyjore dhe kullotë, Bzhetë – Dedaj në komunën Shkrel të qarkut Shkodër”, hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.406, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave.


4. Ndalohen tjetërsimi, dhënia në përdorim apo ndryshimi i destinacionit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe komuna Shkrel e qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
121	2122	Bzhetë-Dedaj	Bzhet Dedaj	1	P.Prodhues	30.5	Kullotë	"	"	"



Handwritten notes in French:
SIA C. FERRECHET
NB FAVOR TS MINISTRISE SOURTEL
(16 HA)

SIA C. FERRECHET
NB FAVOR TS MINISTRISE SOURTEL
(16 HA).



URDHËR
Nr.477, datë 27.6.2011

PËR MIRATIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES DHE PROCEDURËS SË HARTIMIT TË AKTIT TË MIRATIMIT DHE AKTIT TË REFUZIMIT PËR APLIKIMET E LEJEVE MINERARE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 3 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikave 5 dhe 10, germa “A3”, “A4”, “B3” dhe “B4” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”,

URDHËROJ:

1. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit, për çdo aplikim për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet dhe shtyrjen e afatit të kësaj leje, përshkruhen në aneksin 1 të këtij urdhri.

2. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve ndërtimore përshkruhen në aneksin 2 të këtij urdhri.

3. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve radioaktive dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje, që dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave, është e njëjtë me aktin e miratimit të ministrit për leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet dhe përshkruhen në aneksin 1 të këtij urdhri.

4. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje përshkruhen në aneksin 3 të këtij urdhri.

5. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve ndërtimore dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje, përshkruhen në aneksin 4 të këtij urdhri.

6. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve radioaktive dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje, që dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave, është e njëjtë me aktin e miratimit të ministrit për leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet dhe përshkruhen në aneksin 3 të këtij urdhri.

7. Forma dhe përmbajtja e aktit të miratimit të ministrit për çdo aplikim për leje minerare kërkim-zbulimi-shfrytëzimi për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, dhe shtyrjen e afatit të kësaj lejeje përshkruhen në aneksin 5 të këtij urdhri.

8. Pas realizmit në QKL nga subjektet minerare të aplikimit për leje minerare kërkim-zbulimi dhe vlerësimit të këtij aplikimi nga ana e institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese, aktit të verifikimit, projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit, programit minimal të punës për kërkim-zbulimin, projektit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimeve për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe planit të rehabilitimit të zonës minerare, drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), që mbulon veprimtarinë minerare harton aktin e miratimit të lejes minerare, i cili pasi firmoset nga ministri, dërgohet në mënyrë elektronike në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), brenda afateve ligjore.

9. Pas realizmit në QKL nga subjektet minerare të aplikimit për leje minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, dhe vlerësimit të këtij aplikimi nga ana e institucionit të Agjencisë Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese, aktit të verifikimit, projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, programit të investimit për shfrytëzimin ose kërkim-zbulim-shfrytëzimin, projektit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimeve për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe planit të rehabilitimit të zonës minerare, drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), që mbulon veprimtarinë minerare harton aktin e miratimit të lejes minerare, i cili, pasi firmoset nga ministri, dërgohet në mënyrë elektronike në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) brenda afateve ligjore.

10. Për lejet minerare, vendimi përfundimtar i miratimit të lejes njoftohet dhe hyn në fuqi në datën e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, sipas legjislacionit në fuqi, data e publikimit konsiderohet data efektive e dhënies së lejes minerare.

11. Për lejet që përfshijnë shfrytëzimin, vendimi përfundimtar i miratimit, përveç rasteve kur parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave ose nga Kuvendi, njoftohet nëpërmjet publikimit në Regjistrin

Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, data e publikimit konsiderohet data efektive e dhënies së lejes minerare.

12. Për rastet e parashikuara në pikën 5 të nenit 15; pikën 10, neni 24 dhe pikën 6, neni 26 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, kur kërkohet që zona e lejuar e shfrytëzimit të hiqet nga fondi pyjor e kullosor, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.

13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtoria përkatëse në METE, që mbulon veprimtarinë minerare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

ANEKSI 1

FORMATI DHE PËRMBAJTJA E AKTIT TË MIRATIMIT TË MINISTRIT PËR APLIKIMET PËR LEJE MINERARE KËRKIM-ZBULIMI PËR GRUPIN E MINERALEVE METALORE, JOMETALORE, QYMYRET DHE BITUMET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore
Drejtoria Minerare dhe Industriale

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, faqja web: <http://www.mete.gov.al>

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2011

AKTMIRATIMI NR. _____

Për aplikimin në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) për leje minerare kërkim-zbulimi nr. (numri i aplikimit sipas QKL-së), datë (data e aplikimit sipas QKL-së), dorëzuar nga ana e subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR), për zonën minerare nr. (numri i zonës minerare të shpallur në hartën e planit vjetor minerar), të publikuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit (viti i planit vjetor minerar), për mineralet 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, për objektin (emri i objektit minerar), në vendburimin e (emri i vendburimit/masivit), në rrethin e (emri i rrethit), të qarkut të (emri i qarkut).

1. Të dhëna për përfituesin e lejes minerare të kërkim-zbulimit:

- a) Emri i subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);
- b) Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes (emri i personit që është pronar/aksionar i vetëm ose aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor mazhoritar);
- c) Lloji i mineralit për të cilin miratohet leja (emrat e mineraleve 1....., 2..... etj.);
- d) Adresa e selisë së subjektit (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);
- e) Emri dhe mbiemri i administratorit (sipas ekstraktit të regjistrimit të subjektit në QKR);
- f) Nr. i telefonit/faksit (numri i telefonit, faksit që do të shërbejë për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL);
- g) Emërtimi i njësisë vendore ku do të kryhet aktiviteti (fshati/qyteti, rrethi, qarku);
- h) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik (sipas kontratës me drejtuesin teknik që ndodhet në aplikimin e subjektit në QKL);
- i) Data e përfundimit të certifikatës profesionale të drejtuesit teknik (sipas certifikatës së drejtuesit teknik).

2. Kjo leje jepet në përputhje me nenin 11 dhe kreun IV të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe i siguron të

drejtën ekskluzive subjektit përfitues të kryejë punime për kërkim-zbulimin mineral brenda zonës së lejuar, të përcaktuar në lejen minerare për një periudhë vlefshmërie prej (afati i miratuar i lejes në vite) (maksimalisht deri në 3 (tre) vjet me mundësi të zgjatjes vetëm një herë të afatit për 1 (një) vit, me kërkesë të zotëruesit të lejes së paku 30 ditë kalendarike para mbarimit të afatit fillestar të vlefshmërisë) nga data efektive e dhënies së lejes për kërkim-zbulim.

3. Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të kërkim-zbulimit të mineraleve: 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet.

4. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit janë:

X	Y
.....
.....
.....

Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është (.....) km² (një e tërë, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare sipas programit të veprimit, dhe jo më të madhe se 100 (njëqind) km². Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit është përshkruar në hartën që i bashkëngjitet këtij akti miratimi, firmoset nga Ministri, ka vulën e METE-s dhe është pjesë e tij.

5. Përfituesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë, që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit të mineraleve për të cilët i është dhënë kjo leje.

6. Përfituesi i lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të kërkim-zbulimit duhet të realizojë programin minimal të punës dhe atë të investimit sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme:

Periudhat e punës sipas viteve të punës	Faza sipas llojit të aktivitetit	Shpenzimet për programin minimal	Shpenzimet për programin e investimit
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i	Faza
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i	Faza
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i	Faza
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i	Faza
.....
Totali

7. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit për realizimin e programit minimal të punës do të përmbajë këto operacione pune (1.....; 2.....; etj.) me një vlerë totale prej (.....) dhe vlerë vjetore (.....).

8. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit për realizimin e programit të investimit do të kërkojë realizimin e shpenzimeve financiare me një vlerë totale prej (.....) dhe vlerë vjetore (.....).

9. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës është (.....).

10. Vlerat vjetore të garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës janë për vitin e parë (.....) dhe për vitin e dytë (.....).

11. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit është (.....).

12. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit është (.....).

13. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit në zonën e lejuar minerare të kërkimit, duhet të respektojë këto kondita specifike: 1....., 2....., 3....., 4..... etj. (kushte që përfshijnë përcaktimin e variantit optimal të veprimtarisë minerare të

kërkim-zbulimit, në rastet kur projekti i zhvillimit të veprimtarive minerare jepet me disa variante, problematikën e rrezikut gjeologjik, të sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, mjedisit, trajtimit të mbetjeve, dëmtimit të tokës etj.).

14. Data efektive e lejes minerare të kërkim-zbulimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Licencimit.

15. Përfituesi i kësaj lejeje duhet të respektojë përmbushjen në afat dhe me korrektësi detyrat e lëna nga strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese, të përcaktuara sipas ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe detyrave të përcaktuara në legjislacionet përkatëse për krijimin e këtyre strukturave përgjegjëse.

16. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me faks pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit për rastet e ankimit për revokimin apo pezullimin e kësaj lejeje, sipas mënyrës së parashikuar në ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

17. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me faks pranë:

MINISTRIT zotit _____

i) me postë: Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” 1001, Tiranë, Shqipëri

ii) me fax.: nr.

ZOTËRUESI I LEJES SË KËRKIM-ZBULIMIT

ZOTËRUESIT TË LEJES SË KËRKIM-ZBULIMIT zotit. (Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes.)

Shoqërisë (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);

i) me postë (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);

ii) me fax (numri i faksit që do të shërbejë për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL).

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS

* Shënim.

1. Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon ose nuk është aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor mazhoritar, kalimi i të drejtave të lejes minerare të kërkim-zbulimit të zotëruesit të ri, bëhet në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.262, datë 29.4.2011 “Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare”.

2. Në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë në zonën e lejuar ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin e lejes, të cilat nuk kanë të bëjnë me kriteret e lejimit, kërkesa trajtohet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 26 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë në zonën e lejuar ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin e lejes, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e lejimit, kërkesa trajtohet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 27 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Përgjegjësia e personave që zotërojnë lejen e kërkim-zbulimit është e përbashkët dhe veç e veç përballë shtetit në lidhje me këtë leje kërkim-zbulimi.

Ky aktmiratim shoqërohet me aktin e verifikimit të SHGJSH-së për lejen minerare, vlerësimin për kushtet e lejimit të SHGJSH-së, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit dhe vendimin e Këshillit Teknik të SHGJSH-së nr, datë

MINISTRI
Firma, vula

Tiranë më, .../... /2011

FORMATI DHE PËRMBAJTJA E AKTIT TË MIRATIMIT TË MINISTRIT PËR APLIKIMET
PËR SHTYRJE TË AFATIT TË LEJES MINERARE KËRKIM-ZBULIMI PËR GRUPIN E MINERALEVE
METALORE, JOMETALORE, QYMYRET DHE BITUMET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore
Drejtoria Minerare dhe Industriale

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, faqja web: <http://www.mete.gov.al>

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2011

AKTMIRATIMI NR. _____

Për aplikimin në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) nr. (numri i aplikimit sipas QKL-së), datë (data e aplikimit sipas QKL-së), dorëzuar nga ana e subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR), për shtyrje të afatit të lejes minerare kërkim-zbulimi nr. (numri i lejes minerare sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së), datë (data efektive e lejes sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së), zotëruar nga ana e subjektit (emri i subjektit zotërues të lejes minerare sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së), për zonën minerare nr. (numri i zonës minerare), për mineralet 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, për objektin (emri i objektit minerar), në vendburimin e (emri i vendburimit/masivit), në rrethin e (emri i rrethit), të qarkut të (emri i qarkut).

1. Të dhëna për zotëruesin e lejes minerare të kërkim-zbulimit:

a) Emri i subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);

b) Identifikimi i lejes minerare: leje minerare kërkim-zbulimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet nr. (numri i lejes minerare sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së), datë (data efektive e lejes sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së);

c) Emri dhe mbiemri i zotëruesit të lejes (emri i subjektit zotërues të lejes minerare sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së);

d) Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja (emrat e mineraleve 1....., 2..... etj.);

e) Adresa e selisë së subjektit (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);

f) Emri dhe mbiemri i administratorit (sipas ekstraktit të regjistrimit të subjektit në QKR);

g) Nr. i telefonit/faksit (numri i telefonit, faksit që shërben për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL);

h) Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti (fshati/qyteti, rrethi, qarku);

i) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik (sipas kontratës me drejtuesin teknik që ndodhet në aplikimin e subjektit në QKL);

j) Data e përfundimit të certifikatës profesionale të drejtuesit teknik (sipas certifikatës së drejtuesit teknik).

2. Kjo shtyrje në afat e lejes së kërkim-zbulimit jepet në përputhje me nenin 14 dhe kreun IV të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe i siguron të drejtën ekskluzive subjektit përfitues të kryejë punime për kërkim-zbulimin minerar brenda zonës së lejuar të përcaktuar në lejen minerare, për një periudhë vlefshmërie prej një viti nga data efektive e shtyrjes së afatit të lejes për kërkim-zbulim.

3. Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të kërkim-zbulimit të mineraleve: 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet.

4. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit janë:

X	Y
.....
.....
.....

Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është (.....) km² (jo më e madhe se 10% e zonës së lejuar fillestare të lejes së kërkim-zbulimit). Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit është përshkruar në hartën që i bashkëngjitet këtij akti miratimi, firmoset nga Ministri, ka vulën e METE-s dhe është pjesë e tij.

Vlera totale e pagesës për sipërfaqen e zonës së lejuar minerare është (.....).

5. Përfituesi i shtyrjes në afat të lejes minerare të kërkim-zbulimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë, që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit të mineraleve për të cilët i është dhënë kjo leje.

6. Përfituesi i shtyrjes në afat të lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të kërkim-zbulimit duhet të realizojë programin e investimit, sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme:

Periudhat e punës sipas viteve të punës	Faza sipas llojit të aktivitetit	Shpenzimet për programin e investimit
Periudha (.../.../.....-.../.../.....)	Faza
Periudha (.../.../.....-.../.../.....)	Faza
Periudha (.../.../.....-.../.../.....)	Faza
Periudha (.../.../.....-.../.../.....)	Faza
.....
Totali

7. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit për realizimin e programit të investimit do të kërkojë realizimin e shpenzimeve financiare me një vlerë totale prej (.....) dhe vlerë vjetore (.....).

8. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit është (.....).

9. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit është (.....).

1. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit në zonën e lejuar minerare të kërkimit, duhet të respektojë këto kondita specifike: 1....., 2....., 3....., 4..... etj. (kushte që përfshijnë përcaktimin e variantit optimal të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit, në rastet kur projekti i zhvillimit të veprimtarive minerare jepet me disa variante, problematikat e rrezikut gjeologjik, të sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, mjedisit, trajtimit të mbetjeve, dëmtimit të tokës etj.).

10. Data efektive e shtyrjes së afatit të lejes minerare të kërkim-zbulimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Licencimit.

11. Përfituesi i kësaj lejeje duhet të respektojë përmbushjen në afat dhe me korrektësi detyrat e lëna nga strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese, të përcaktuara sipas ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe detyrave të përcaktuara në legjislacionet përkatëse për krijimin e këtyre strukturave përgjegjëse.

12. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje, ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me faks pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit për rastet e ankimimit për revokimin apo pezullimin e kësaj lejeje, sipas mënyrës së parashikuar në ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet, në Republikën e Shqipërisë”.

13. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje, ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me faks pranë:

MINISTRIT zotit _____

i) me postë: Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” 1001, Tiranë, Shqipëri

ii) me fax.: nr.

ZOTËRUESI I LEJES SË KËRKIM-ZBULIMIT

ZOTËRUESIT TË LEJES SË KËRKIM-ZBULIMIT zotit. (Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes.)
Shoqërisë (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);
i) me postë (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);
ii) me fax (numri i faksit që do të shërbejë për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL).

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

* Shënim.

1. Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon ose nuk është aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor mazhoritar, kalimi i të drejtave të lejes minerare të kërkim-zbulimit të zotëruesi i ri, bëhet në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.262, datë 29.4.2011 “Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare”.

2. Në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë në zonën e lejuar, ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin e lejes, të cilat nuk kanë të bëjnë me kriteret e lejimit, kërkesa trajtohet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 26 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë në zonën e lejuar ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin e lejes, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e lejimit, kërkesa trajtohet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 27 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Përgjegjësia e personave që zotërojnë lejen e kërkim-zbulimit është e përbashkët dhe veç e veç përballë shtetit në lidhje me këtë leje kërkim-zbulimi.

Ky aktmiratim shoqërohet me vlerësimin e kërkesës nga SHGJSH-ja për shtyrjen e afatit, vlerësimin për kushtet e lejimit të SHGJSH-së, opinionen e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit dhe vendimin e Këshillit Teknik të SHGJSH-së nr..., datë

MINISTRI

Tiranë më, .../... /2011

ANEKSI 2

FORMATI DHE PËRMBAJTJA E AKTIT TË MIRATIMIT TË MINISTRIT PËR APLIKIMET PËR LEJE MINERARE KËRKIM-ZBULIMI PËR GRUPIN E MINERALEVE NDËRTIMORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore
Drejtoria Minerare dhe Industriale

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, faqja web: <http://www.mete.gov.al>

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___ / ___ / 2011

AKTMIRATIMI NR. _____

Për aplikimin në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) për leje minerare kërkim-zbulimi nr. (numri i aplikimit sipas QKL-së), datë (data e aplikimit sipas QKL-së), dorëzuar nga ana e subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR), për zonën minerare nr. (numri i zonës minerare të shpallur në hartën e planit vjetor minerar), të publikuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit (viti i planit vjetor minerar), për mineralet 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për objektin (emri i objektit minerar), në vendburimin e (emri i vendburimit/masivit), në rrethin e (emri i rrethit), të qarkut të (emri i qarkut).

1. Të dhëna për përfituesin e lejes minerare të kërkim-zbulimit:
 - a) Emri i subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);
 - b) Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes (emri i personit që është pronar/aksionar i vetëm ose aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor mazhoritar);
 - c) Lloji i mineralit për të cilin miratohet leja (emrat e mineraleve 1....., 2..... etj.);
 - d) Adresa e selisë së subjektit (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);
 - e) Emri dhe mbiemri i administratorit (sipas ekstraktit të regjistrimit të subjektit në QKR);
 - f) Nr. i telefonit/faksit (numri i telefonit, faksit që do të shërbejë për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL);
 - g) Emërtimi i njësisë vendore ku do të kryhet aktiviteti (fshati/qyteti, rrethi, qarku);
 - h) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik (sipas kontratës me drejtuesin teknik që ndodhet në aplikimin e subjektit në QKL);
 - i) Data e përfundimit të certifikatës profesionale të drejtuesit teknik (sipas certifikatës së drejtuesit teknik).

Kjo leje jepet në përputhje me nenin 19 dhe kreun IV të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe i siguron të drejtën ekskluzive subjektit përfitues të kryejë punime për kërkim-zbulimin mineral brenda zonës së lejuar, të përcaktuar në lejen minerare, për një periudhë vlefshmërie prej (afati i miratuar i lejes në vite) (maksimalisht deri në 1 (një) vit, pa mundësi shtyrje të afatit) nga data efektive e dhënies së lejes për kërkim-zbulim.

2. Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të kërkim-zbulimit të mineraleve: 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore.

3. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit janë:

X	Y
.....
.....
.....

Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është (.....) km², një e tërë, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare sipas programit të veprimit, dhe jo më të madhe se 10 (dhjetë) km². Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit është përkrahur në hartën që i bashkëngjitet këtij akti miratimi, firmoset nga Ministri ka vulën e METE-s dhe është pjesë e tij.

4. Përfituesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë, që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit të mineraleve për të cilët i është dhënë kjo leje.

5. Përfituesi i lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të kërkim-zbulimit, duhet të realizojë programin minimal të punës dhe atë të investimit sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme:

Periudhat e punës sipas viteve të punës	Faza sipas llojit të aktivitetit	Shpenzimet për programin minimal	Shpenzimet për programin e investimit
Periudha (.../.../...-.../.../...)	Faza
Periudha (.../.../...-.../.../...)	Faza
Periudha (.../.../...-.../.../...)	Faza
.....
Totali

6. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit për realizimin e programit minimal të punës do të përmbajë këto operacione pune (1.....; 2.....; etj.) me një vlerë totale prej (.....).

7. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit për realizimin e programit të investimit do të kërkojë realizimin e shpenzimeve financiare me një vlerë totale prej (.....).

8. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës është (.....).

9. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit është (.....).

10. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit në zonën e lejuar minerare të kërkimit, duhet të respektojë këto kondita specifike: 1....., 2....., 3.....,

4..... etj. (kushte që përfshijnë përcaktimin e variantit optimal të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit, në rastet kur projekti i zhvillimit të veprimtarive minerare jepet me disa variante, problematikat e rrezikut gjeologjik, të sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, mjedisit, trajtimit të mbetjeve, dëmtimit të tokës etj.).

11. Data efektive e lejes minerare të kërkim-zbulimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Licencimit.

12. Përfituesi i kësaj lejeje duhet të respektojë përmbushjen në afat dhe me korrektësi detyrat e lëna nga strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese, të përcaktuara sipas ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe detyrave të përcaktuara në legjislacionet përkatëse për krijimin e këtyre strukturave përgjegjëse.

13. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje, ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me faks pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit për rastet e ankimimit për revokimin apo pezullimin e kësaj lejeje sipas mënyrës së parashikuar në ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

14. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me faks pranë:

MINISTRIT zotit _____

i) me postë: Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” 1001, Tiranë, Shqipëri

ii) me fax.: nr.

ZOTËRUESI I LEJES SË KËRKIM-ZBULIMIT

ZOTËRUESIT TË LEJES SË KËRKIM-ZBULIMIT zotit. (Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes.)

Shoqërisë (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);

i) me postë (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);

ii) me fax (numri i faksit që do të shërbejë për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL).

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

* Shënim.

1. Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon ose nuk është aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor mazhoritar, kalimi i të drejtave të lejes minerare të kërkim-zbulimit të zotëruesit të ri, bëhet në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.262, datë 29.4.2011 “Për miratimin e kritereve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare”.

2. Në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë në zonën e lejuar ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin e lejes, të cilat nuk kanë të bëjnë me kriteret e lejimit, kërkesa trajtohet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 26 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë në zonën e lejuar ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin e lejes, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e lejimit, kërkesa trajtohet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 27 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Përgjegjësia e personave që zotërojnë lejen e kërkim-zbulimit është e përbashkët dhe veç e veç përballë shtetit në lidhje me këtë leje kërkim-zbulimi.

Ky aktmiratim shoqërohet me aktin e verifikimit të SHGJSH-së për lejen minerare, vlerësimin për kushtet e lejimit të SHGJSH-së, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit dhe vendimin e Këshillit Teknik të SHGJSH-së nr, datë

MINISTRI
Firma, vula

Tiranë më, .../... /2011

ANEKSI 3
FORMATI DHE PËRMBAJTJA E AKTIT TË MIRATIMIT TË MINISTRIT PËR APLIKIMET PËR LEJE
MINERARE SHFRYTËZIMI PËR GRUPIN E MINERALEVE METALORE, JOMETALORE, QYMYRET
DHE BITUMET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore
Drejtoria Minerare dhe Industriale

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, faqja web: <http://www.mete.gov.al>

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2011

AKTMIRATIMI NR. _____

Për aplikimin në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) për leje minerare shfrytëzimi nr. (numri i aplikimit sipas QKL-së), datë (data e aplikimit sipas QKL-së), dorëzuar nga ana e subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR), për zonën minerare nr. (numri i zonës minerare të shpallur në hartën e planit vjetor minerar), të publikuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit (viti i planit vjetor minerar), për mineralet 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, për objektin (emri i objektit minerar), në vendburimin e (emri i vendburimit/masivit), në rrethin e (emri i rrethit), të qarkut të (emri i qarkut).

1. Të dhëna për përfituesin e lejes minerare të shfrytëzimit:

- a) Emri i subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);
- b) Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes (emri i personit që është pronar/aksionar i vetëm ose aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor mazhoritar);
- c) Lloji i mineralit për të cilin miratohet leja (emrat e mineraleve 1....., 2..... etj.);
- d) Adresa e selisë së subjektit (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);
- e) Emri dhe mbiemri i administratorit (sipas ekstraktit të regjistrimit të subjektit në QKR);
- f) Nr. i telefoni/faksit (numri i telefonit, faksit që do të shërbejë për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL);
- g) Emërtimi i njësisë vendore ku do të kryhet aktiviteti (fshati/qyteti, rrethi, qarku);
- h) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik (sipas kontratës me drejtuesin teknik që ndodhet në aplikimin e subjektit në QKL);
- i) Data e përfundimit të certifikatës profesionale të drejtuesit teknik (sipas certifikatës së drejtuesit teknik).

Kjo leje jepet në përputhje me nenin 15 dhe kreun IV të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe i siguron të drejtën ekskluzive subjektit përfitues të shfrytëzojë llojet e mineralit/mineraleve, të përcaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit, për një periudhë vlefshmërie prej (afati i miratuar i lejes në vite) (maksimalisht deri në 25 (njëzetepesë) vjet me mundësi të zgjatjes vetëm një herë të afatit për 10 (dhjetë) vjet, me kërkesë të zotëruesit të lejes së paku 1 (një) vit para mbarimit të afatit fillestar të vlefshmërisë) nga data efektive e dhënies së lejes për shfrytëzim.

2. Kjo leje jepet për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineraleve: 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet.

3. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së shfrytëzimit janë:

X	Y
.....
.....
.....

Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare është (.....) km² (një e tërë, jo më e vogël se vlera e përcaktuar në tabelën e miratuar me vlerat minimale të sipërfaqeve të lejeve minerare sipas programit të

veprimin, dhe jo më e madhe se 10 (dhjetë) km². Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së shfrytëzimit është përshkruar në hartën që i bashkëngjitet këtij akti miratimi, firmoset nga Ministri ka vulën e METE-s dhe është pjesë e tij.

4. Përfituesi i lejes minerare të shfrytëzimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë, që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineraleve për të cilët i është dhënë kjo leje. Në mënyrë të specifikuar kërkohet respektimi i afateve ligjore për rastet kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar ose ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar.

5. Përfituesi i lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të shfrytëzimit, duhet të realizojë programin e investimit vjetor dhe atë të investimit total sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme:

Periudhat e punës sipas viteve të punës	Shpenzimet vjetore për programin e investimit	Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit	Shpenzimet kumulative për programin e investimit
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i
.....
Totali

6. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit për realizimin e programit të investimit do të përmbajë këto operacione pune (1.....; 2.....; etj.) me një vlerë totale prej (.....) dhe vlerë vjetore sipas përshkrimit në tabelën më sipër.

7. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e programit të investimit është (.....).

8. Vlerat vjetore të garancisë financiare për realizimin e programit të investimit janë për vitin e parë (.....), për vitin e dytë (.....), për vitin e (.....) etj.

9. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit është (.....).

10. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit është (.....).

11. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit në zonën e lejuar minerare të shfrytëzimit duhet të respektojë këto kondita specifike: 1....., 2....., 3....., 4..... etj. (kushte që përfshijnë përcaktimin e variantit optimal të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit, në rastet kur projekti i zhvillimit të veprimtarive minerare jepet me disa variante, problematikat e rrezikut minerar, të sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, mjedisit, trajtimit të mbetjeve, dëmtimit të tokës etj.).

12. Data efektive e lejes minerare të shfrytëzimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Licencimit.

13. Përfituesi i kësaj lejeje duhet të respektojë përmbushjen në afat dhe me korrektësi për detyrat e lëna nga strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese, të përcaktuara sipas ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe detyrave të përcaktuara në legjislacionet përkatëse për krijimin e këtyre strukturave përgjegjëse.

14. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje, ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me faks pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit për rastet e ankimimit për revokimin apo pezullimin e kësaj lejeje sipas mënyrës së parashikuar në ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

15. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me faks pranë:

MINISTRIT zotit _____

i) me postë: ADRESA Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” 1001, Tiranë, Shqipëri

ii) me fax.: nr.

ZOTËRUESI I LEJES SË SHFRYTËZIMIT

ZOTËRUESIT TË LEJES SË SHFRYTËZIMIT zotit. (Emri dhe mbiemri i përfituesit të lejes.)

Shoqërisë (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);

i) me postë (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);

ii) me fax (numri i faksit që do të shërbejë për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL).

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

* Shënim.

1. Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon ose nuk është aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor mazhoritar, kalimi i të drejtave të lejes minerare të shfrytëzimit të zotëruesit të ri, bëhet në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.262, datë 29.4.2011 “Për miratimin e kritereve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare”.

2. Në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë në zonën e lejuar ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin e lejes, të cilat nuk kanë të bëjnë me kriteret e lejimit, kërkesa trajtohet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 26 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në rastin kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë në zonën e lejuar ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në titullin e lejes, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e lejimit, kërkesa trajtohet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 27 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Përgjegjësia e personave që zotërojnë lejen e shfrytëzimit është e përbashkët dhe veç e veç përballë shtetit në lidhje me këtë leje shfrytëzimi.

Ky aktmiratim shoqërohet me aktin e verifikimit të AKBN-së për lejen minerare, vlerësimin për kushtet e lejimit të AKBN-së, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit dhe vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së nr, datë

MINISTRI
Firma, vula

Tiranë më, .../... /2011

FORMATI DHE PËRMBAJTJA E AKTIT TË MIRATIMIT TË MINISTRIT PËR APLIKIMET PËR SHTYRJE TË AFATIT TË LEJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT PËR GRUPIN E MINERALEVE METALORE, JOMETALORE, QYMYRET DHE BITUMET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore
Drejtoria Minerare dhe Industriale

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001, faqja web: <http://www.mete.gov.al>

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2011

AKTMIRATIMI NR. _____

Për aplikimin në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) nr. (numri i aplikimit sipas QKL-së), datë (data e aplikimit sipas QKL-së), dorëzuar nga ana e subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR), për shtyrje të afatit të lejes minerare shfrytëzimi nr. (numri i lejes minerare sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve

4037

dhe Licencave të QKL-së), datë (data efektive e lejes sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së), zotëruar nga ana e subjektit (emri i subjektit zotëruar të lejes minerare sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së), për zonën minerare nr. (numri i zonës minerare), për mineralet 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, për objektin (emri i objektit minerar), në vendburimin e (emri i vendburimit/masivit), në rrethin e (emri i rrethit), të qarkut të (emri i qarkut).

1. Të dhëna për zotëruar të lejes minerare të shfrytëzimit:
 - a) Emri i subjektit (emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR);
 - b) Identifikimi i lejes minerare: leje minerare shfrytëzimi për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet nr. (numri i lejes minerare sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së), datë (data efektive e lejes sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së);
 - c) Emri dhe mbiemri i zotëruar të lejes (emri i subjektit zotëruar të lejes minerare sipas Regjistrimit Kombëtar të Lejeve dhe Licencave të QKL-së);
 - d) Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja (emrat e mineraleve 1....., 2..... etj.);
 - e) Adresa e selisë së subjektit (adresa e subjektit sipas regjistrimit në QKR);
 - f) Emri dhe mbiemri i administratorit (sipas ekstraktit të regjistrimit të subjektit në QKR);
 - g) Nr. i telefonit/faksit (numri i telefonit, faksit që shërben për kontaktimin zyrtar me subjektin sipas aplikimit në QKL);
 - h) Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti (fshati/qyteti, rrethi, qarku);
 - i) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik (sipas kontratës me drejtuesin teknik që ndodhet në aplikimin e subjektit në QKL);
 - j) Data e përfundimit të certifikatës profesionale të drejtuesit teknik (sipas certifikatës së drejtuesit teknik).

Kjo shtyrje në afat e lejes së shfrytëzimit jepet në përputhje me nenin 16 dhe kreun IV të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe i siguron të drejtën ekskluzive subjektit përfitues të shfrytëzojë llojet e mineralit/mineraleve, të përcaktuara në leje, por brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit, për një periudhë vlefshmërie prej 10 (dhjetë) vitesh nga data efektive e shtyrjes së afatit të lejes për shfrytëzim (me kërkesë të zotëruar të lejes së paku 1 (një) vit para mbarimit të afatit fillestar të vlefshmërisë).

2. Kjo shtyrje në afat e lejes jepet për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineraleve: 1....., 2..... etj., që bëjnë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet.

3. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së shfrytëzimit janë:

X	Y
.....
.....
.....

